



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 079/1 Pro

Tiranë, 15.01 2018

**Lënda: Dërgim udhëzimi për zbatim**

**TË GJITHË DEPARTAMENTEVE**

**TË GJITHË DEGËVE DOGANORE**

Bashkëlidhur po ju dërgojmë për zbatim:

- Udhëzimin numer 02....., datë 15.01...2018 “Deklarimi i mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje “on line” nga individët nëpërmjet operatorëve postarë”
- Manuali për vendosjen në qarkullim të lirë të dërgesave postare dhe blerjeve on-line të hyra nëpërmjet operatorëve postar në Sistemin Asycuda World

Të merren të gjitha masat për zbatim.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda IKONOMI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 879 Prot.

Tiranë, më 15 / 1 /2018

## UDHËZIM

Nr. 02 datë 15 / 1 /2018

**“Mbi zbatimin e procedurave për deklarimin dhe çlirimin në qarkullim të lirë të mallrave personale me natyrë jo tregtare të hyra si dërgesa postare ose blerje “on-line” nga individët nëpërmjet operatorëve postarë.**

Mbështetur në nenet 10, 48, 52, 119 deri 140, 146 deri 155, 184, 188, 203 dhe 204 të Ligjit 102/2014, datë 31.7.2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, dhe në nenet 160, 179 deri 194, 234 deri 242, 246 deri 249, 253 deri 258, 303 deri 329, 356 deri 359, 420 deri 424, 606, 607, dhe 725 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 75/2012, datë 26.07.2012 “Për ratifikimin e akteve dhe të dokumenteve të Kongresit të 24 të Bashkimit Postar të Përhotoshëm (UPU), Gjenevë 2008”

Me qëllim të thjeshtimit, standartizimit dhe përfshirjen në sistemin kompjuterik doganor të procedurave për deklarimin në doganë të mallrave me natyrë jo tregtare nga individë, vlera e të cilave kalojnë kufirin e vlerës së përjashtuar nga detyrimet në import;

Bazuar në 737 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

## UDHËZON

### 1. Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi.

---

1.1 **“Dërgesë postare”** konsiderohen mallrat, përveç artikujve të korrespondencës, të përfshira në një pako ose paketë postare të përcjellë nën përgjegjësinë ose përmes një operatori postar në përputhje me dispozitat e Konventës së Bashkimit Universal Postar, miratuar më 10 korrik 1984, nën kujdesin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

1.2 **“Mallra të natyrës jotregtare”** nënkuptojmë mallrat që ndodhen në dërgesat e dërguara nga një person (individ) tek një person tjetër dhe;

- janë të një natyre rastësore;
- përmbajnë mallra ekskluzivisht për përdorim personal të marrësit ose të familjes së tij dhe për nga natyra ose sasia nuk paraqesin interes tregtar; dhe
- u janë dërguar marrësit nga dërguesi pa asnjë lloj pagese;

1.3 **“Blerje on-line”** konsiderohet transaksioni nëpërmjet të cilit, mallrat që blihen (porositen) në internet, nga individët, importohen përmes dërgesave postare.

1.4 **“Operator Postar”** konsiderohet një operator i licensuar, i vendosur në Republikën e Shqipërisë që ofron shërbime ndërkombëtare të rregulluara nga Konventa Universale Postare.

1.5 **“Artikuj korrespondence”** janë, letrat, kartolinat, letrat me shkrim për të verbërit si dhe materiale të shtypura/të printuara që nuk i nënshtrohen detyrimit të importit ose eksportit.

1.6 **“Person (individ)”** konsiderohen, personat fizikë natyrorë të ndryshëm nga personat e tatueshëm që veprojnë si të tillë siç përcaktohet nga legjislacioni përkatës në fuqi.

1.7 **“Kufiri i vlerës së papërfillshme”** quhet kufiri i vlerës doganore mbi të cilin çdo person duhet të paguajë detyrimet doganore.

1.8 **“Deklaratë e thjeshtuar”**, do të konsiderohet formati i posacëm i deklaratës doganore me të dhëna (rubrika) të reduktuara.

1.9 **“Deklaratë përmbledhëse e dërgesave postare”** do të quhet, deklarata doganore (DAV) për regjimin IM4, që plotësohet në mënyrë automatike nga sistemi me të dhënat e deklaratave të thjeshtuara të regjistruara në një periudhë të përcaktuar.

1.10 **“Agjent postar”**, është punonjësi i Operatorit Postar, i licensuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të kryer deklarimin e mallrave të hyra si dërgesa postare.

1.11 **“Zyre doganore mbikqyrese”** konsiderohet zyra doganore nën kompetencën territoriale të cilës gjenden ambientet e Magazinit të Përkohshëm që administrohen nga Operatori Postar.

---

---

## **2. Procedura të Përgjithshme**

- 2.1 Për të mundësuar një deklaram të thjeshtuar për çdo dërgesë (pako) të mbërritur nëpërmjet shërbimit postar, në sistemin informatik doganor vihet në funksionim “Moduli për deklarimin e thjeshtuar të mallrave me natyrë jo tregtare të importuara nga individë nëpërmjet operatorëve postar”. Nëpërmjet këtij moduli kryhet deklarim i thjeshtuar për çdo dërgesë (pako) dhe në fund të ditës mundësohet depozitimi i deklaratës doganore përmbledhëse të dërgesave postare për regjimin IM4 të të gjithë dërgesave (pakove) të çliruara atë ditë.
- 2.2 Ky modul do të përdoret vetëm për deklarimin e mallrave të importuara nga persona (individë) të cilët importojnë për qëllime personale dhe vetëm nga operatorët postar të cilët disponojnë ambjentet për magazinim të përkohshëm të miratuara nga autoritetet doganore.
- 2.3 Deklarimi i thjeshtuar në sistemin informatik të doganës do të kryhet për mallrat “dërgesa postare” që dërgohen nga një individ jo rezident në territorin shqiptar për një individ rezident në këtë territor si dhe për mallrat e blera on-line për nevoja personale të cilat, kanë natyrë jo-tregtare dhe kalojnë kufirin e vlerës (të përcaktuar në nenet 316, 420 dhe 423, të VKM nr.651, datë 10.11.2017 Dispozitat Zbatuese;
- mbi 22 euro për blerjet on line,
  - mbi 45 euro per dërgesa postare dhe
  - nën 1000 euro.
- 2.4 Për mallra me vlerë nën kufijtë e përcaktuara si vlerë e papërfillshme deklarimi doganor nga agjenti postar konsiderohet i depozituar (i bërë gojarisht), sipas nenit 146, pika 2 e Kodit Doganor dhe nenit 304, pika 1/a,b të Dispozitave Zbatuese
- 2.5 Për mallra të përmendura në pikën 2.3 dhe vlera e të cilave është mbi 1000 Euro, deklarimi duhet të bëhet me deklaratë standarte IM 4 (DAV).

## **3. Procedurat që zbatohen lidhur me hyrjen, deklarimin dhe çlirimin e dërgesave postare.**

- 3.1 Deklarimi nëpërmjet sistemit kompjuterik do të kryhet nga agjentë të operatorëve postar të cilët janë të licensuar nga administrata doganore. Operatorët postar nëpërmjet një kërkesë përcaktojnë agjentët e licensuar që, do të kenë akses në sistemin informatik doganor për të kryer deklarimin në emër të tyre dhe për llogari të personave (individëve) të cilet, përdorin këtë operator për shërbimin e transportit të dërgesës së tyre.

### 3.2 Veprimet në degën doganore hyrëse;

- a) Në rastet kur ambjentet e magazinimit të përkohshëm në administrim të Operatorit Postar nuk janë nën mbikqyrjen e zyrës doganore hyrëse, me mbërritjen e ngarkesës postare në kufi, agjenti postar depoziton deklaratën doganore sipas modelit T1. Pas depozitimit të deklaratës autoritetet doganore të zyrës hyrëse kryejnë të gjitha formalitetet doganore të nevojshme për verifikimin dhe vendosjen e mallrave në regjimin e tranzitit, njësoj si për të gjithë mallrat që hyjnë në territorin doganor shqiptar.
- b) Në rastet kur ambjentet e magazinimit të përkohshëm në administrim të Operatorit Postar janë nën mbikqyrjen e zyrës doganore hyrëse, agjenti postar depoziton manifestin e mallrave në sistem.
- c) Lëvizja e mallrave nga ambjentet e magazinimit të përkohshëm të doganës hyrëse në ambjentet e magazinimit të përkohshëm të Operatorit Postar, bëhet nën përgjegjësinë e këtij të fundit në përputhje me nenin 256 të Vendimit nr.651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” .

### 3.3 Veprimet në zyrën doganore mbikqyrëse;

- a) Me mbërritjen e mallrave në ambjentet e magazinimit të përkohshëm të miratuar Operatori Postar depoziton manifestin në sistemin kompjuterik.
- b) Për të gjitha dërgesat (pakot postare), autoritetet doganore të zyrës mbikqyrëse, bazuar mbi një analizë risku lokale, autoritetet doganore përcaktojnë dërgesat që vlerësohen me risk dhe për të cilat duhet të kryhet kontrolli fizik. Këto dërgesa janë në statusin e magazinimit të përkohshëm deri në momentin e daljes nga ambjentet e tij dhe vendosjes së tyre në qarkullim të lirë.
- c) Dërgesat me vlerë nën kufirin e vlerës së papërfillshme çlirohen, duke u konsideruar se janë vendosur në qarkullim të lirë sipas pikës 2.4 të këtij Udhëzimi, nëpërmjet mbylljes manuale (spontimit) të manifestit, rast pas rasti, për çdo pako të çliuar.

### 3.4 Formalitetet që zbatohen për deklaratën e thjeshtuar;

Deklarimi i dërgesave (pakove postare) për mallrat që kanë vlerë brënda kufijve të përcaktuar sipas pikës 2.3 të këtij Udhëzimi do të bëhet nëpërmjet deklaratës së thjeshtuar në sistemin kompjuterik doganor.

---

Për këtë formë deklarimi, nga ana e Operatorit Postar nëpërmjet agjentit postar;

- hapet dhe plotësohet me shumën përkatëse të parashikuar, llogaria parapaguese,
- kërkohet regjistrimi i autorizimit për deklarim të thjeshtuar, nga zyra doganore mbikqyrëse, për sasinë e mallrave dhe detyrimin doganor të parashikuar dhe
- për çdo pako të dalë nga ambjenti i përcaktuar depozitohet një deklaratë e thjeshtuar

Nga ana e doganierit të zyrës mbikqyrëse, rast pas rasti;

- regjistrohet autorizimi për deklarim të thjeshtuar
- kontrollohet në sistem derdhja e detyrimeve nga operatori postar në llogarinë parapaguese.
- regjistrohet deklarata e thjeshtuar e depozituar,
- pas regjistrimit të deklaratës së thjeshtuar e printon atë në dy kopje,
- nënshkruan dhe vulos deklaratën e thjeshtuar dhe
- së bashku me pakon ja dorëzon agjentit të operatorit postar.

Në këtë moment pako është çliruar dhe vendosur në qarkullim të lirë.

Në fund të ditës së punës, agjenti postar depoziton deklaratën përmbledhëse të dërgesave postare sipas standartit të Dokumentit Administrativ të Vetëm (DAV) për regjimin IM4, e cila gjenerohet nga deklaratimet e thjeshtuara të regjistruara deri në atë moment.

Në këtë deklaratë, në kutinë 37 të saj, vendoset kodi i procedurës 4000 dhe kodi shtesë DPS. Ky kod shtesë mundësohet nga sistemi kompjuterik doganor vetëm për Operatorët Postar të licensuar.

---

Doganieri i zyrës mbikqyrëse kryen të gjitha veprimet e nevojshme për miratimin dhe pranimin e deklaratës doganore sipas procedurës normale përcaktuar në Udhëzimin nr. 01, datë 14.01.2011 "Mbi procedurën e përpunimit të deklaratës doganore (DAV) në sistemin Asycuda World".

Hapat që ndiqen për deklarimin janë të pasqyruara në "Manualin për vendosjen në qarkullim të lirë të dërgesave postare të hyra nëpërmjet operatorëve postar në Sistemin Asycuda World".

Deklarata e printuar duhet të ketë bashkëlidhur të gjithë deklarimet e thjeshtuara dhe depozitohet për tu arkivuar pranë zyrës doganore mbikqyrëse, sipas legjislacionit në fuqi.

#### **4. Rastet përjashtimore të përdorimit të deklaratës së thjeshtuar.**

4.1 Nuk lejohet të deklarohen nëpërmjet këtij moduli (deklaratë e thjeshtuar):

- Për blejret on-line, mallrat e përcaktuara në nenin 421 të Dispozitave Zbatuese (produktet alkoolike, parfumet dhe ujë tualeti, duhani dhe produktet e duhanit).
- Për dërgesat postare nga një individ rezident jashtë territorit shqiptar në një individ brenda këtij territori, me vlerë nën kufirin e papërfillshëm të vlerës së pataksueshme dhe sasia është mbi kufirin e përcaktuar në nenin 424 të VKM nr. 651 datë 10.11.2017. Lista e këtyre produkteve dhe sasisë përkatëse janë të paraqitura në aneksin I, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

- Dërgesat (pakot postare) që kanë vlerë mbi 1000 euro

Për rastet e paraqitura më sipër deklarimi do të bëhet me deklaratë doganore standarte IM 4 (DAV) me procedurë (sipas kutise 37 të DAV) normale.

Për dërgesat (pakot postare) dhe blerje on-line, të cilat kanë vlerë që është nën nivelin e kufirit të pataksuar, këto pako çlirohen duke i konsideruar se janë vendosur në qarkullim të lirë sipas deklarimit (të bërë gojarisht), sipas nenit 146, pika 2 e Kodit Doganor dhe nenit 304, pika 1/a,b të Dispozitave Zbatuese. Në rastet kur në sistem është depozituar manifest për këto mallra, bill-et që i korenspondojnë këtyre dërgesave do të mbyllen manualisht nga punonjësi doganor.

## 5. Zbatimi

5.1 Udhëzimi nr. 3, dt. 05.09.2011, shfuqizohet.

5.2 Për zbatimin e këtij Udhëzimi ngarkohen të gjithë zyrat doganore në të cilat do të kryhen deklarime për dërgesat postare dhe blerjet on-line të cilat janë mallra për qëllime jo tregtare të importuara nga individë.

5.3 Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën 01.02.2018 dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Belinda IKONOMI**



## ANEKS 1

### **I. Mallra me vlerë të papërfillshme**

Në përputhje me nenin 421 të Dispozitave Zbatuese , çdo dërgesë mallrash me karakter jotregtar, e përbërë nga mallra me vlerë të papërfillshme, që importohen nëpërmjet dërgesave postare, vlera e të cilave nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 22 euro janë të përjashtuara nga detyrimet doganore

**Përjashtimi nuk zbatohet për mallrat e mëposhtme:**

- a) produktet alkoolike;
- b) parfumet dhe ujë tualeti;
- c) duhanet dhe produktet e duhanit.

### **II. Dërgesa të dërguara falas nga një individ tek një tjetër**

1. Në përputhje me nenet 422, 423 dhe 424 të Dispozitave Zbatuese, mallrat që përbëjnë dërgesat që dërgohen nga një individ nga një vend tjetër tek një individ tjetër që jeton në territorin doganor të Republikës së Shqipëri përjashtohen nga detyrimet e importit, me kusht që këto importe nuk janë të natyrës tregtare dhe nuk kalon vlerën ekuivalente në lekë të shumës 45 Euro, duke përfshirë edhe vlerën e mallrave të përmendur në pikën 3.

2. Kur vlera e përgjithshme për një dërgesë e përbërë prej dy ose më shumë artikujve e kalon shumën e përmendur në pikën 1, përjashtimi deri në atë shumë jepet për këta artikuj, nëse të importuar veçmas do t'u jepej përjashtimi, me kusht që vlera e një artikulli individual nuk mund të ndahet.

3. Përjashtimi i parashikuar në pikën 1 të nenit 422 të Dispozitave Zbatuese, duhet të kufizohet, për dërgesë, në sasi të dhëna për çdo mall të listuar si më poshtë:

- a) produkte të duhanit:
  - 50 cigare,
  - 25 cigarillos (puro e hollë e vogël me peshë maksimale deri në tri gramë secila),
  - 10 cigare puro,
  - 50 gramë duhan për tymosje, ose
  - një përzgjedhje proporcionale nga këto produkte të ndryshme;



b) alkool dhe pije alkoolike:

- pije të distiluara dhe pije alkoolike me përbërje alkooli mbi 22% të vëllimit; etil alkool jo i denaturuar me vëllim 80% e më tepër: 1 liter, ose
- pije të distiluara dhe pije alkoolike, si dhe aperitivë me bazë vere apo alkooli, rum, sake apo pije të ngjashme alkoolike me përbërje alkooli që nuk kalon 22% të vëllimit; verëra me gaz, verëra likerit: një litër apo një përzierje proporcionale nga këto produkte të ndryshme, dhe
- verë e pa gazuar: dy litra;

c) parfume:

- 50 gram, ose
- ujëra tualeti: 0,25 litra.

## MANUAL

### PËR VENDOSJEN NË QARKULLIM TË LIRË TË DËRGESAVE POSTARE TË HYRA NËPËRMJET OPERATORËVE POSTARË NË SISTEMIN ASYCUDA ËORLD

Deklarimi në Sistemin Asycuda Ëorld i mallrave që hyjnë nëpërmjet operatorëve postar si dërgesa postare do të kryhet nëpërmjet modulit të deklarimit të thjeshtuar në sistemin informatik doganor Asycuda Ëorld duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

1. Autorizim për deklarimin e procedurës së thjeshtuar
2. Deklarimi i Thjeshtuar për vendosjen e dërgesave postare në qarkullim të lirë
3. Deklarimi Përmbledhës

Për të bërë deklaratat sipas hapave të sipërpërmendur në sistem, agjentët e postës duhet të pajisen me autorizim/liçensë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për të deklaruar/përfaqësuar. Operatori postar përcakton personat që do të depozitojnë nëpërmjet sistemit Asycuda Ëorld autorizimin, deklarimin e thjeshtuar dhe deklaratën përmbledhëse. Për këta persona depozitohet një kërkesë në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për të bërë të mundur aksesin për këto lloj deklarimesh.

Për totalin e dërgesave postare që do të dalin në ditë nga ambjentet e magazinimit të përkohshëm depozitohet një autorizim për deklarimin e thjeshtuar. Në autorizim deklarohet vlera totale e dërgesave postare që operatori postar parashikon të nxjerrë brenda ditës, për të cilat është bërë parapagesa e detyrimit doganor përkatës. Në bazë të autorizimit të marrë, operatori postar nxjerr mallin nga ambjentet e përcaktuara të doganës duke depozituar një deklaratim të thjeshtuar për çdo pako të dalë.

Në përfundim të ditës depozitohet deklarimi përmbledhës për të gjithë deklaratat e thjeshtuara nëpërmjet procedurës normale të deklarimit për vendosje në qarkullim të lirë (duke depozituar DAV në sistem). Të dhënat e deklaratave të thjeshtuara gjenerohen automatikisht nga sistemi në deklaratën IM 4.

Në vijim janë të pasqyruara veprimet që ndiqen në sistem për deklarimin e dërgesave postare.

#### 1. Autorizimi për deklarimin e procedurës së thjeshtuar

##### *Krijimi i autorizimit*

Deklaruesi/përfaqësuesi (agjenti i operatorit postar) depoziton në sistem Autorizimin për Deklarimin e Procedurës së Thjeshtuar sipas Formës së Autorizimi për Deklarimin e Procedurës së Thjeshtuar duke ndjekur hapa si më poshtë:

Hap një formë të re autorizimi duke klikuar:

- Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/Periodic Entry/Formë Autorizimi/E Re




Fig.1 Depozitimi i autorizimit

- Plotësohet forma e autorizimit sipas fushave. Të dhënat e kërkuara janë:

<b>Zyra doganore Mbikqyrëse</b>	Kodi i zyrës mbikqyrëse (psh AL110000)
<b>Referenca e autorizimit</b>	Është numër unik, vendoset nga operatori postar. Numri unik mund të fillojë me vitin, kodin e zyrës, kodin e monedhes etj.
<b>E vlefshme nga ----deri</b>	Data e marrjes së autorizimit—deri —data e mbarimit të autorizimit
<b>Mbajtësi i autorizimit</b>	Nipt i operatorit postar që do të kryej deklarin e mallrave postare
<b>Kodi i deklaruesit</b>	Kodi i identifikimit si deklarues i operatorit postar. Këtë të dhënë sistemi e merr automatikisht nga përdoruesi i sistemit
<b>Llogaria paguese</b>	Numri i llogarisë paguese të detyrimeve (NIPT i operatorit)
<b>Emri dhe adresa e kompanisë së huaj dërguese</b>	Emri dhe adresa e kompanisë së huaj që ka eksportuar këto mallra në Shqipëri – mund të shënohet “dergesa postare”
<b>E vlefshme për import</b>	Plotësohet nga vet sistemi kur zgjidhet modeli deklarimit IM 4
<b>Model i deklarimit</b>	Zgjidhet nga lista duke klikuar ne procedurën 4000
<b>Procedurat e zgjeruara</b>	Zgjidhet nga lista kodin “DPS”
<b>Dokumenti tregtar që përdoret</b>	Zgjidhet kodin i dokumentit që përdoret si bazë për deklarimin në autorizim (si dokument përdoret fatura)
<b>Shuma e Faturës</b>	Vlera e faturës (shumat totale e pakove të dala në ditë)
<b>Incoterms</b>	Klikohet mbi listë për të zgjedhur inkotermën përkatëse (psh CIF)
<b>Vendi i Origjinës</b>	Vendi i origjinës së mallit- mund të vendoset vendi i origjinës me nr. me te madh te dergesave
<b>Kodi i preferencës dhe</b>	Plotësohen nëse ka të tilla

<b>kuotat</b>	
<b>Numri maksimum i ditëve për deklarim</b>	Vendoset numri maksimum i ditëve për të bërë deklaraimin përmbledhës. Ky numër mund të jetë 1 ose më shumë.
<b>Autoriteti që lëshon Autorizimin</b>	Dega doganore që lëshon autorizimin
<b>Data e lëshimit të autorizimit</b>	Plotësohet nga sistemi
<b>Kodet tarifore të autorizuara</b>	Klikohet në "Commodities" dhe pasi shfaqet një dritare e re klikohet "shto kodin tarifor". Kodi tarifor mund të shënohet me 2, 4 ose më shumë shifra dhe klikohet "OK".

Në vijim forma e autorizimit e plotësuar:

The screenshot displays the ASYCUDA software interface for an authorization form. The window title is "Authorization Form - New [AL110000]". The form is titled "Authorisation Form for Simplified Declaration Procedure".

**Customs Office of processing:** AL110000, Tirana

**Authorisation reference:** 2017110001

**Valid from:** 12/01/2018 **To:** 12/02/2018

**Authorisation holder code:** J61924007N **POSTA SHQIPTARE SHA**

**Declarant code:** J039 **Posta Shqiptare' sh.a**

**Payment Account reference:** J61924007N

**Name and address of the foreign Commercial Partner:** Dergesa Postare

**Address: Country of commercial partner:** AL, Albania

**Valid for export:**  **Import:**  **Model of declaration:** JM, 4 **Extended CPC:** 4000 **National:** DPS

**Commercial document to be used:** 080 **Invoice**

**Invoice Amount:** 10,000.00 **EUR** **Euro**

**Incoterms:** CIF **Kosto, sigurim dhe transport**

**Place of delivery:** Tirane

**Country of origin code:** IT **Italia**

**Preference code:**

**Quota reference:**

**Maximum number of days for the declaration:** 5

**Authority issuing the authorisation:**

**Name:**

Fig. 2. Forma e autorizimit të plotësuar




Fig. 3. Përcakto kapitujt ne autorizim

Mund të përcaktohen të gjithë kapitujt e mundshëm sipas pakove që vijnë.




Fig. 4 Kapitujt e përcaktuar në autorizim

Pasi plotësohet autorizimi dhe përcaktohen kapitujt bëhet ruajtja/depozitimi i autorizimit .



Fig. 5 Ruajtja/depozitimi i autorizimit

Autorizimi i depozituar nga deklaruesi, duhet të regjistrohet nga punonjësi doganor. Bazuar në vlerën e mallrave agjenti i postës duhet të llogarisë detyrimet doganore dhe të hedhë ato në një bankë të nivelit të dytë për llogari të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (llogari parapaguese). Doganieri bënë të vlefshëm autorizimin në sistem pasi kontrollon:

- të dhënat e autorizimit
- nëse detyrimet doganore për vlerën e mallrave në autorizim janë parapaguar.

Autorizimi bëhet i vlefshëm në sistem duke klikuar:

- Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/Periodic Entry/Formë Autorizimi/Gjej, si më poshtë:




Fig. 6. Gjetja autorizimit

Kërkon nëpërmjet numrit të autorizimit të depozituar nga agjenti i postës ose me ndonjë të dhënë tjetër sipas fushave më poshtë.




Fig. 7. Kërkimi i autorizimit

Përzgjidhet autorizimi që duhet të bëhet i vlefshëm në sistem, duke klikuar me të djathtën përzgjidhet “register stored” për ta regjistruar atë.




Fig. 8. Regjistrimi i autorizimit

Në dritaren e mesazhit “regjistrimi direkt nga depozitimi është bërë” klikohet butoni  si vijon:




Fig. 9. Regjistrimi direkt

Në këtë moment autorizimi për deklarimin e thjeshtuar është bërë i vlefshëm në sistem. Në bazë të autorizimit të marrë deklaruesi kryen deklarimin e thjeshtuar për çdo dërgesë (pako) që tërheq për ta dërguar tek klienti. Për një autorizim mund të ketë një ose disa deklarime të thjeshtuara.

## 2. Deklarimi i thjeshtuar

Pasi është bërë depozitimi i autorizimit (shiko pikën 1), për çdo ngarkesë që del nga ambjentet e magazinimit të përkohshëm, agjenti i postës përgatit deklarimin e thjeshtuar duke hapur një formë të re deklarimi të thjeshtuar si më poshtë:

- Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/Periodic Entry/Formë Autorizimi/E Re




Fig. 10. Hap deklaratën e thjeshtuar

- Plotësohen të dhënat e Deklarimit të thjeshtuar

Zyra doganore	Zyra e doganore në të cilën kryhet deklarimi
Referenca e Autorizimit	Vendoset që është shënuar në kutinë “Referenca e Autorizimit” të Autorizimit për deklarim të thjeshtuar që përket ky deklarim i thjeshtuar (p.sh. 2017110001)
Data / Koha / Turn / Resht	Plotësohen nga vet sistemi
Identifikimi mjetit	Vendosen numri i identifikimit të klientit (ID)
Tarifa Doganore	Vendoset kodi 8-shifror në kutinë e parë, në nënndarjen e dytë vendoset kodi shtesë për 11-shifror
Numri i njësisë statistikore	Vendosen sasia sipas njësisë plotësuese të përcaktuar nga kodi i nomenklaturës së mallrave
Origjina / Kodi Proc. Dog. të zgjeruar /Kodi zgjeruar Kombëtar	Vendosen nga sistemi sipas të dhënave të plotësuara në autorizimin përkatës
Pesha bruto/ Pesha neto	Pasha e mallit për pakon në fjalë
Vlera e faturës	Vlera e faturës për mallrat që po dalin
Nr. dhe data e dokumentit	Nr. dhe data e faturës/AWB
Referenca e Deklarimit	Plotësohet nga sistemi pas pranimit të deklaratës DAV-it
Përshkrimi	Vendosen përshkrimi i mallrave dhe vëndi nga eksportohe/origjina

Pasi janë plotësuar të gjitha të dhënat klikohet “store- depozito”.



File Edit View Help

ASYCUDA

Line Transaction

Customs Reference

Customs Office  
AL110000 Tirana

Authorisation reference Date Time Shift # Line #  
2017110001

Means of Transport Consignee Code Consignee Name  
40 IT 00000456H AL J61924007N POSTA SHQIPTARE SH.A

Customs Tariff commodity code Number of statistical unit Code  
61069090 000 5 C62

Description  
Veshje  
Spanje  
Detyrimi Doganor 2000 lek

Origin Preference Extended CPC National CPC Quota reference #  
IT 4000 DPS

Gross weight (KG) Net weight (KG) Invoice value Currency  
1.00 1.00 100.00 EUR

Number & date of reference document Declaration reference  
38045635 01/01/2018

Fig. 11. Deklarata e thjeshtuar

Line Transaction - New [AL110000]

File Edit View Help

ASYCUDA

Line Transaction

Customs Reference

Transaction completed

Store is done

Print Line Transaction, condensed

e-Mail to:

Fig. 12. Depozitimi i deklarimit të thjeshtuar

Deklarimi thjeshtuar i depozituar nga deklaruesi, duhet të konfirmohet nga dogana. Doganieri regjistron deklarin e thjeshtuar në sistem duke klikuar:

- Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/Periodic Entry/Line transaction/Gjej.

Doganieri shikon deklarin e thjeshtuar nëpërmjet “Modifiko” dhe nëse të gjitha të dhënat janë në përputhje me të dhënat në dokumentin e pakos, selekton me të djathtën deklarin e thjeshtuar që do të regjistroj, klikon “regjistro direkt”. Në dritaren e mesazhit “transaksioni u kompletua” klikon butonin”  . Deklarimi i thjeshtuar është regjistruar ka marrë një numër nga sistemi.




Fig. 13. Regjistro deklaratën




Fig. 14. Numri i Deklaratës së thjeshtuar

Deklarata e Thjeshtuar e regjistruar printohet në dy kopje të cilat firmosen, vulosen nga punonjësi doganës. Kjo deklaratë i jepet agjentit të operatorit postar së bashku me pakon. Deklarata e thjeshtuar jepet një kopje për klientin dhe një për ta bashkangjitur me DAV-in.


Në të njëjtën mënyrë veprohet për deklarimet e thjeshtuara për çdo pako, për sa kohë që ka një autorizim të vlefshëm.

### 3. Deklarata DAV IM4 (Deklarimi Përmbledhës)

Në fund të ditës së punës, bëhet deklarimi përmbledhës për pakot e dala nga magazinimi i përkohshëm nëpërmjet deklarimeve të thjeshtuara.

Agjenti i operatorit postar, përgatit deklarimin e detajuar DAV IM4 në sistem duke hapur një deklaratë të re:

- Asycuda/Zhdoganimi/Deklaratë/e re.

Në panelin e butonave të formës së deklaratës së detajuar klikohet butoni  “gjenero periodikisht deklarimin përmbledhës”. Pasi klikohet butoni shfaqet një dritare e cila kërkon të dhëna për zyrën doganore dhe referencën e autorizimit. Vendoset kodi i zyrës doganore (psh AL110000) dhe referenca e autorizimit (duhet të vendoset referenca e autorizimit për të cilin po bëhet deklarimi i detajuar psh 2017110001) dhe klikohet “OK”.




Fig. 15. Deklarata IM 4




Fig. 16. Gjenerimi i të dhënave nga deklaratat e thjeshtuara




Fig. 17. Të dhënat për gjenerim

Në këtë moment sistemi gjeneron të dhëna përmbljedhëse për të gjitha deklaratimet e thjeshtuar të regjistruara për autorizimin në fjalë dhe plotëson disa nga fushat e deklaratës si: kutinë 2 (eksportuesi- në këtë rast janë shumë dhe mund të shënohet dergesa postare), kutinë 8 (importuesi – në këtë rast quhet operatori postar), kutinë 22 (vlera dhe monedha), kutinë 33 (kodin tarifor), kutinë 8 (marrësi), kutinë 34 (kodi i vendit origjinës), kutinë 35 dhe 38 (pesha neto, pasha bruto), kutinë 37 (regjimi), kutinë 41 (njësitë plotësuese) etj.

Pas gjenerimit të të dhënave në deklaratën IM 4, agjenti duhet të plotësojë dhe disa fusha të tjera të deklaratës për të cilat nuk gjenerohen të dhëna nga deklaratimet e thjeshtuara. Në vijim po japim të dhënat që janë të detyrueshme për tu plotësuar në deklaratën IM 4.

<b>Numri i pakove (kutia 6)</b>	Numri total i pakove që kanë dalë nga deklaratimet e thjeshtuara të ditës
<b>Vëndi eksportues i fundit (kutia 11, 15)</b>	Do të plotësohet me një nga shtetet që ka pakot me të shumta
<b>Mjeti transportit në kufi (kutia 18, 21)</b>	Linja me të cilën kanë hyrë pakot
<b>Mënyra e transportit në kufi dhe të brëndshëm (kutia 25, 26)</b>	Kodi mënyrës së transportit psh 40- ajrore, 31- tokësore
<b>Dogana hyrëse (kutia 29)</b>	Kodi doganës hyrëse (psh AL130000)
<b>Natyra e transaksionit (kutia 24)</b>	Vendosen kodin I/I
<b>Vëndi destinacionit (kutia 17)</b>	Vendosen AL
<b>Numri dhe lloji i pakove (kutia 31)</b>	Vendoset nr. i pakove që i përket një kodin tarifor
<b>Lloji i paketimit (kutia 31)</b>	Vendos kodin 21- kartona
<b>Vlerësimi (kutia 43)</b>	Vendos kodin 1

Në vijim pamjet me plotësimet e mësipërme në deklaratën IM 4.

<b>ASYCUDA</b> A OFFICE OF DEPARTURE AL130000 Tirana Customs Reference Manifest 2017	
<b>3 Exporter</b> Dergesa Postare Ya neryshme IT - Roma	<b>1 TR CI ANALYSIS</b> 3 Form 1 4 Lines List 5 Form 1 6 Nbr packages 7 Manifest number
<b>8 Consignee</b> POSTA SHQIPTARE SHA No. J61924007N	<b>9 Principal</b> No.
<b>14 Declarant</b> "POSTA SHQIPTARE" sh.a Nr. RREGHI ÇOROKU, nr.4 TIRANE No. J039	<b>10 Country last</b> GB <b>11 Trading</b> GB <b>12 Value details</b> 0
<b>13 Identify and nationality of means of transport at arrival</b> AL ITALIA <b>15 Country of export</b> Albania <b>16 Country of origin</b> Italia <b>17 Country of destination</b> Albania	<b>18 C.E. Code</b> 0 <b>19 C.O. Code</b> AL <b>20 Unbranded</b> CP <b>21 Country &amp; total amount involved</b> ALL 17,000.00 <b>22 Exch. rate</b> 1.000 <b>24 Nat. Code</b> Bank Code Terms of payment
<b>25 Mode transport</b> 40 at border <b>26 Internal mode</b> 31 Transport <b>27 Place of redurgence</b> AL130000 Roma <b>28 Other of entry</b> AL130000 Roma <b>29 Location of goods</b>	<b>30 Location of goods</b>

Fig. 18. Plotësimet në pjesën e përgjithshme të IM 4

<b>31 Packages and description of goods</b> Marks and numbers - Containers No(s) - Number and kind Marks & no of packages Nbr & Kind 5 21 Ctn Nbr Kartona -- Praj materjaleve te tjera tekstile	<b>32 Item</b> 1 No. 61069090 000 <b>33 Commodity code</b> 34 Cty. orig. Code 35 Gross mass (kg) 1.00 36 Prefer. 37 PROCEDURE 38 Net mass (kg) 1.00 39 Quota 4000 DPS <b>40 Summary declaration / Previous document</b> 1 <b>41 Supplementary units</b> C62 42 Item Price 1,000 <b>43 V.M. Code</b>
<b>44 Add. info Documents</b> Licence No D.Val D.Qty	<b>46 Statistical value</b> 11,000 <b>49 Identification of warehouse</b>

Fig. 19. Klasifikimi i pakove sipas kodit

Nëse për të gjitha deklarimet e thjeshtuara të regjistruara në një ditë pune është përdorur vetëm një kod tarifor (61069090), të gjitha deklarimet permblidhen në një deklaratë (pa bis) dhe nr. i pakove i vendosur në kutinë 6 është i njëjtë me atë të vendosur në kutinë 31. Nëse gjatë deklaramëve do të ketë kode të ndryshme tarifore ato gjatë gjenerimit të deklaratës IM 4 shpërndahen në BIS-se (sa kode janë përdorur gjatë ditës atë bis-e krijohen).

<b>MP</b> 0 1 99 1	<b>48 Deferred payment</b> J61924007N <b>B ACCOUNTING DETAILS</b> Mode of payment ACCOUNT PAYMENT Assessment number / Date Receipt number / Date Guarantee 0 Date Total fees 668 ALL <b>Total declaration</b> 4,065 ALL Signature	<b>46 Statistical value</b> 11,000 <b>49 Identification of warehouse</b> <b>C OFFICE OF DEPARTURE</b>
--------------------------	---	--

Fig. 20. Totali i detyrime për deklarimet e ditës

Pasi plotësohet deklarata me të dhënat e tjera të kërkuara, depozitohet dhe regjistrohet sipas procedurës normale të deklarimit të importit. Në momentin që deklarata pranohet dhe merr numrit P, në deklaratat e thjeshtuara mbi bazën e të cilave është bërë kjo deklaratë në kutinë "referenca e deklarimit" pasqyrohet numri R i deklaratës.

ASYCUDA

2 Eksportuesi Nr

Dergesa Postare  
Te ndryshme  
IT - Italia

1 DEKLARATE  
IM 4

3 Formulari Lista  
1 1

A ZYRA E DESTINACIONIT  
AL110000  
Tirana  
Referenca e Doganes  
R 88479 18/10/2017  
Manifesti

Fig. 21. Deklarata e pranuar

Skedar Editto Paraqitje Ndhme

Zyrat Doganore  
AL110000 Tirana

Referenca autorizimit 2017110003 Data 16/10/2017 Koha 10:08 Turn # 1 Rresht # 1

Means of Transport 50 FT 000458123D AL Consignee Code J61924007N Consignee Name POSTA SHQIPTARE SH.A

Tarifa Doganore e mallrave 61089000 000 Numri i njesise statistikore 5 Kodi C62  
Description  
Triko, Spanje

Origjina FT Preferenca KPD te zgjeruar 4000 KPD Kombetar IND Referenca kuotes #

Posha Bruto (KG) 2.00 Posha neto (KG) 2.00 Vlera fatures 10,000.00 Monedha ALL

Numri & data e referencës së dokumentit 1235 02/10/2017 Referenca deklarimit R 88479 18/10/2017

Fig. 21. Pasqyrimi i nr. të regjistrimit të IM 4 në deklaratën e thjeshtuar

**KUJDES!** Të dhënat e autorizimit dhe deklarimit të thjeshtuar duhet të plotësohen shumë të sakta. Nëse keni plotësuar një të dhënë në autorizim apo deklarimin e thjeshtuar jo saktë nuk do të jeni në gjendje të kryeni deklarimin e përmbledhës ose nuk do t'i ndryshoni dot të dhënat.